

STATUTI
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GIRASSOL ENERGIES ALBANIA”

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1


Data e Themelimit, Emri, dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, më **15.06.2023**, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **“GIRASSOL ENERGIES ALBANIA” SH.P.K.**
- 1.2 Themeluesi i shoqërisë është:
- GIRASSOL HOLDING LIMITED, Shoqëri private aksionare, me adresë të selisë “DD-14-122-023 WeWork Hub 71, 14th Floor, Al Khatem Tower, Abu Dhabi Global Market Square, Al Maryah Island, Abu Dhabi, United Arab Emirates.

Neni 2

Objekti

- 2.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston kryesisht në:
- **Ofrimin e shërbimeve të ndryshme për shoqëritë që kryejnë operacione hidrokarbure në kërkim, prodhim dhe/ose zhvillim. Shërbime për optimizimin e kërkimit dhe prodhimit në industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës. Këto shërbime do të fokusohen por pa u limituar në shërbime analizimi të dhënash duke përdorur programe kompjuterike profesionale, sonda apo mjete të tjera të ngjashme. Këshillimi apo ofrimi i asistencës së specializuar për riparime dhe mirëmbajtje të ndryshme, punime ndërtimore, shërbime mjedisore, vënie në dispozicion të mjeteve teknologjike, makinerive, pajisjeve dhe automjeteve, shërbime të transportit të naftës apo fluideve, injektimit të ujrave nëntokësor, pastrimit të mbetjeve hidrokarbure, furnizimin me materiale e pajisje të ndryshme, studime, projektme, shërbime ndërmjetësimi etj.**
 - **Import, eksport, tregti me shumicë e pakicë të hidrokarbureve, si naftë dhe nënproduktet e saj. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash për vete e për të tretë.**
 - **Ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit të marrëveshjeve mes shoqërive tregtare (shqiptare dhe të huaja), ndërmjetësimin e shoqërive tregtare në marrëdhëniet kontraktore mes tyre;**



asistencë në marrëdhënie me institucione financiare private dhe shtetërore. Pjesëmarrje me kuota/aksione në shoqëri tregtare, kryerja e investimeve në shoqëri shqiptare dhe të huaja, menaxhimi dhe drejtimi i shoqërive dhe asistenca në veprimtarinë e tyre.

- Për të arritur objektin e saj. Shoqëria, me vendim të Asamblesë mund të realizojë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

2.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose të shtohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Aktiviteti i Shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3.2 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 4

Selia e Shoqërisë

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në “Njësinë Administrative Nr.5, Bulevardi "Bajram Curri", Ndërtesa 128, Hyrja 26, Kati 2, Ap.9, Tirana, Albania”.
- 4.2 Shoqëria mund të hapë degë, shoqëri bija, zyra përfaqësimi, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose në vende të tjera.
- 4.3 Shoqëria është e aftë të bëjë pjesë në shoqëri të tjera shqipëtare ekzistuese ose në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë ose në vende të tjera.


Neni 5

Forma

- 5.1 Themeluesit kanë themeluar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 5.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 6

Baza Ligjore



- 6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 6.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë vulën e vetë. Administratori do të përdorë vulën.
- 7.2 Të gjitha dokumentet e Shoqërisë duhet të shoqërohen nga vula.

KREU II

Kapitali

Neni 8


Kapitali i Shoqërisë

- 8.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë.
- 8.2 Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 1 (një) kuotë.
- 8.3 Pjesmarrja e themeluesit në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij si më poshtë:
- GIRASSOL HOLDING LIMITED- Pronar i 1 (aksioni) me vlerë të përgjithshme 10.000 (dhjetë mijë) lekë shqiptare që përbën 100% (njëqind për qind) të kapitalit bazë të shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i Kapitalit

- 9.1 Kuotat e kapitalit themeltar të Shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëprmet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2 Për transferimin e kuotave kërkohet miratimi i mëparshëm i shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë kuotën dhe/ose të drejtat e tij, duhet t'i propozojë shitjen më parë ortakëve të tjerë të shoqërisë në të njëjtat kushte.



Neni 10

Rritja e Kapitalit

- 10.1 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë unanimisht për rritjen e kapitalit.
- 10.2 Rritja e kapitalit mund të bëhet edhe nëpërmjet nënshkrimit të kuotave të reja të kapitalit nga ose ortakët e rinj. Ortakët e rinjë do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.3 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 11

Zvogëlimi i Kapitalit

- 11.1 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 11.2 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.


KREU III

Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 12

Organi Vendimmrës

- 12.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 12.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;



- b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) shpërndarjen e fitimeve
 - j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 12.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 12.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.


Neni 13

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me postës elektronike. Njoftimi me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 13.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 14

Kuorumi



- 14.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 14.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 14.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Marrja e vendimeve

- 15.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 15.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 15.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Q.K.B për të pasyqruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 16



Përfundimi nga e drejta e votës

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 17


Administrimi

- 17.1 Asambleja e përgjithshme emëron një person fizik si administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 17.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 17.3 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:
- **Jennifer Afriye**, Shtetas ganez, lindur në ACCRA, Gana, më 26 shkurt 1986, me numër PASS G2470341.

Neni 18

Kompetencat e Administratorit

- 18.1 Administratori kanë të drejtë e detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;




- ç) përgatiti dhe nënshkruajti bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 18.2 Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- 18.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.


Neni 19

Përgjegjësitë e Administratorit

- 19.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 19.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 19.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:



- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 19.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 19.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 19.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
- 19.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- 19.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.
- 19.9 Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



KREU IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 20

Viti Financiar

- 20.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përbashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 21

Ekspertët

- 21.1 Eksperti kontabël i autorizuar zgjidhet më vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 21.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

KREU V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 22

Prishja dhe likuidimi

- 22.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;



- d) me vendim të gjykatës;
- 22.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Neni 23

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- 23.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 24

Mosmarrëveshjet

- 24.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K U I V E T E M

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“GIRASSOL ENERGIES ALBANIA”

GIRASSOL HOLDING LIMITED



15 JUNE 2023

AHMED ALUBARAK

STATUTE
OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY
“GIRASSOL ENERGIES ALBANIA”

CHAPTER I

Foundation, Name, Object, Duration, Headquarters

Article 1

Foundation Date, Name, Form and Founders

- 1.1 Today on 15.06.2023, we, the founders, have founded a limited liability company with the name “GIRASSOL ENERGIES ALBANIA” L.L.C.
- 1.2 The founders of the company are:
- GIRASSOL HOLDING LIMITED, Private Company Limited by Shares, with Address of registered office “DD-14-122-023 WeWork Hub 71, 14th Floor, Al Khatem Tower, Abu Dhabi Global Market Square, Al Maryah Island, Abu Dhabi, United Arab Emirates.

Article 2

Object

- 2.1 The object of the company shall mainly consist in:
- **Providing various services for other companies that carry out research in petroleum operations, production and/or development. Services for the optimization of research and production in the industry of oil processing and extracting. These services will be focused on, but not to be limited to data analysis services using professional computer programs, probes, or other similar tools. Advising or providing specialized assistance for the repairs and maintenance of various construction works, environmental services, provision of technological tools, machines, equipment and vehicles, oil or fluid transportation services, groundwater injection, cleaning of petroleum waste, the supply of various materials and equipment, studies, designs, mediation services, etc.**



- Wholesale, importing, exporting and retailing petroleum, such as oil and its by-products. National and international transport of goods for their own and for third parties.
- Providing mediation services for the agreements between commercial companies (Albanian and foreign), mediation of commercial companies in contractual relations between them; assistance in relations with private and state financial institutions. Participation with quotas/shares in commercial companies, making investments in Albanian and foreign companies, management and direction of other companies and as well as assistance in their activities.
- To reach its objective. The company, with the decision of the Assembly, can participate in other companies' activities, with them being Albanian or foreign.

Article 3

Duration

- 3.1 The activity of the company will commence after its registration at the Commercial Registry of the National Center of Business.
- 3.2 The company is established for an indeterminate period of time.

Article 4


Headquarters

- 4.1 The headquarter of the company is situated at: "Njësia Administrative Nr.5, Bulevardi "Bajram Curri", Ndërtesa 128, Hyrja 26, Kati 2, Ap.9, Tirana, Albania";
- 4.2 The company may establish branches, affiliates and representative offices, within the territory of Albania or in other countries.
- 4.3 The company will be able to participate in other Albanian companies, existing or future ones in the Republic of Albania or in other countries.

Article 5

Legal Form

- 5.1 The founders have established a Limited Liability Company in accordance with the commercial legislation in force in the Republic of Albania.



- 5.2 The company may be transformed into another form in compliance with the Albanian legislation.

Article 6

Legal Grounds

- 6.1 The company will carry out its activity in compliance with this Statute and the legal provisions of the Albanian Legislation.
- 6.2 Unless otherwise provided in this Statute, shall apply the provisions of the Law “On the entrepreneurs and Commercial Companies”, Civil Code and any other specific law of the Republic of Albania

Article 7

Seal

- 7.1 The company will have its seal. The administrator shall use the seal.
- 7.2 All documents of the company shall be affixed to the seal.

CHAPTER II

Capital

Article 8

Basic Capital

- 8.1 The initial basic capital of the company is 10.000 (ten thousand) Albanian Lek.
- 8.2 Capital is divided in 1 (one) share.
- 8.3 The participation of the founders in the basic capital of the company is in accordance with their contributions as follows:
- Founding Member: GIRASSOL HOLDING LIMITED- Owner of 1(share) with the general value of 10.000(ten thousand) Albanian lek that constitutes 100%(one hundred percent) of the basic capital of the company.

Article 9

Transfer of Capital Shares

- 9.1 Shares and the rights they confer shall be acquired or transferred through:
- a) Participation in the authorized share capital at the incorporation of the company;



- b) Purchase;
- c) Inheritance;
- ç) Donation;
- d) Other ways provided by the Law.

9.2 The transfer of shares, in particular, requires the company's approval. Members intending to transfer their shares and/or their rights, must first propose the share to the other company Member at the same conditions.

Article 10

Capital Increase

- 10.1 The Assembly of Members shall unanimously decide to increase the capital of the company.
- 10.2 Capital increase may also be made through subscription and paying-in of new capital shares by new Members. New Members shall be accepted and approved by the decision of the Assembly of Members.
- 10.3 The majority cannot obligate, under any circumstances, a member to increase his contribution in the basic capital of the company.


Article 11

Decrease of Capital

- 11.1 The decrease of the capital is allowed by the General Assembly, which will take the decision under the same conditions as for the amendment to the Statute.
- 11.2 In all cases the decrease of the capital affects the partners to the same extent as their respective parts in the capital.

CHAPTER III

Decision-Making and Directing Organs



Articles 12

Decision-Making Organ

- 12.1 The General Assembly of Members is the only decision-making organ of the company.
- 12.2 The General Assembly of Partners is the only decision-making organ of the company that approves any amendments to the Statute according to the modalities foreseen by the Law.
- 12.3 The General Assembly shall decide on the following company matters:
- a) Setting the business policies;
 - b) Amendments to the Statute;
 - c) Election and dismissal of the Administrators;
 - ç) Election and dismissal of independent auditors and liquidators;
 - d) Establishment of remunerations to persons mentioned under Numbers “c” and “ç”;
 - dh) Monitoring and supervising the implementation of business policies by Managing Directors, including preparation of the annual statement of accounts and the performance report;
 - e) Adoption of the annual statement of accounts and performance reports;
 - ë) Increase and decrease of basic capital;
 - f) Dividing shares into parts and withdrawal of shares;
 - g) Representation of the company in court and in other proceedings against Administrator;
 - gj) Company restructuring and dissolution of legal form;
 - h) Adoption of its own rules of procedure;
 - i) Distribution of annual profits
 - j) Other matters set by law or the Statute.
- 12.4 A member may be represented at the General Assembly by another member authorized by him or another authorized third party. The letter of authorization shall be issued for only one General Assembly Meeting including the reconvened meeting
- 12.5 The Administrator of the company cannot act as a representative of another member at the General Assembly Meeting.

Article 13

Method of Convening the General Assembly Meeting

- 13.1 The General Assembly Meeting shall be convened by electronic mail. The e-mail shall contain the place or link, date and hour of the meeting and be delivered together with the agenda to all members not later than 7 days before the scheduled date of the meeting



- 13.2 Where the General Assembly Meeting has not been convened in conformity with Paragraph 1, the General Assembly Meeting may adopt decisions only if all the partners of the company agree to take decisions despite the irregularity

Article 14


Quorum

- 14.1 In case of matters requiring an ordinary majority, the General Assembly Meeting may only take valid decisions if attended by members holding more than 30% of the subscribed voting shares.
- 14.2 In case of matters requiring a qualified majority, as of Article 87, of the Law “On Entrepreneurs and Commercial Companies” the General Assembly Meeting may only take valid decisions if the partners having more than half of the total number of votes are participating in the voting in persona, by letter, or by electronic means in accordance with paragraph 3 of Article 88 of this Law.
- 14.3 If the General Assembly Meeting could not be held due to lack of the quorum referred to in Paragraph 1, the meeting shall be reconvened with the same proposed agenda within 30 days.

Article 15

Decision-Making

- 15.1 The General Assembly shall decide by three-quarter majority of votes of partners participating in the voting on the amendment to the Statute, the decrease of the basic capital, profit distribution, company restructuring and dissolution or other matter related to the conflict of interest provided by the law.
- 15.2 The General Assembly shall decide by majority of votes of participating partners for other issues such as:
- a) Setting the business policies;
 - b) Election and dismissal of the Administrators;
 - c) Election and dismissal of independent auditors and liquidators;
 - ç) Establishment of remunerations
 - d) Monitoring and supervising the implementation of business policies by the Administrators including preparation of the annual statement of accounts and the performance report;



- e) Representation of the company in court and in other proceedings against the Administrators;
 - f) Adoption of its own rules of procedure on convening the General Assembly Meeting;
- 15.3 Any amendment to the Statute must be submitted at the NRB in order to reflect the changes in the file of the company.

Article 16

Exclusion of Voting Rights

- 16.1 A member may not vote if the General Assembly decides on:
- a) Assessing his performance
 - b) Releasing from any of his obligations
 - c) Any claim against him on behalf of the company
 - ç) Granting or not of any new benefit.
- 16.2 Where a member is represented by authorization, the representative shall be deemed to be in the same position regarding conflicts of interest as the member he represents.

Article 17

Administration

- 17.1 The General Assembly shall nominate one or more natural persons as Administrators of the company for a term established by the Statute not exceeding 5 years, with the possibility of re-election. The nomination has legal effect once it is registered in the National Business Centre.
- 17.2 The Administrators of a parent company according to Article 207 of this Law may not be elected Administrators of a subsidiary and vice-versa. Any election made contrary to this provision is null and void.
- 17.3 The following person is appointed as the first Administrator of the company until his appointment from the first General Assembly:
- **Jennifer Afriye**, Ghanian citizen, born in ACCRA, Ghana, on 26 Feb 1986, with PASS number G2470341.

Article 18

Rights and Obligations of the Administrator




- 18.1 The Administrator has the right and obligation to:
- a) Manage the company's business by implementing the policies defined by the General Assembly;
 - b) Represent the company;
 - c) Ensure that the necessary accountancy books and documents are kept;
 - ç) Prepare and sign the annual statement of accounts and consolidated accounts and the performance report and present it to the General Assembly for approval together with the proposals for the distribution of profits;
 - d) Create an early warning system with respect to developments threatening the existence of the company;
 - dh) File for the registrations and submit the mandatory data of the company according to the Law on the National Business Center;
 - e) Report to the General Assembly with respect to the implementation of business policies and to the realization of transactions of particular importance for company performance;
 - ë) Perform other duties set by law or the Statute.
- 18.2 The Administrators are obligated to convey the General Assembly in cases when:
- according to the annual balance sheet or interim accounts reports result or exist the risk that the assets of the company will not cover up its liabilities within the next 3 months.
 - the company proposes to sell or otherwise dispose on the assets amounting to more than 5% of the company's assets resulting in the last certified financial statements.
 - the company, within the first 2 years after registration, proposes to purchase assets which belong to a member and which amount to 5% of the company's assets resulting in the last certified financial statements.
- 18.3 The General Assembly may dismiss the Administrator at any time by ordinary majority. Any claims, as for the compensation of the administrator, arising from any contractual relationship are governed by the legal provisions in force.


Articles 19

Responsibilities of the Administrator

- 19.1 The Administrator is liable towards the Company or third parties for damages caused by breach of the laws of the Statute, or for faults committed during the administration of the society.
- 19.2 The consequences for any unapproved agreement from the Assembly, that brings damages to the company, are charged on the Administrator and the Member that has made the agreement to face individually or jointly as the case may be the respective consequences.



- 19.3 Apart from what is provided in the general provisions on the fiduciary duty, according to articles 14, 15, 17 and 18 of the Law “On the Entrepreneurs and Commercial Companies, the administrator is obliged to:
- a) Perform his duties established by the law and the Statute in good faith in the best interests of the company as a whole which includes the environmental sustainability of its operations;
 - b) Exercise powers granted to him by the law and the Statute only for the purposes established therein;
 - c) Give adequate consideration to matters to be decided;
 - ç) Avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the company;
 - d) Perform his duties with professionalism and reasonable care.
- 19.4 The Administrator during the performance of his duties is held liable for any action or failure to act reasonably related with the purpose of the commercial company, unless the action or omission was made in good faith, based upon reasonable inquiry and information, and rationally related to the purposes of the company.
- 19.5 In case when the Administrator acts in violation of his duties and infringes the professional standards according to points 1 and 2 of this Article, he is obliged to compensate the company for any damage which occurred due to the violation, as well as to disgorge any personal profits made by him or the person connected with him, in violation of his duties to the company. The Administrator has the burden of proving compliance with the duties and standards. In case the violation has been committed by more than one of the Administrators, they are jointly and severally liable towards the company.
- 19.6 In particular, but not limited to these, the Administrator is obliged to compensate the company for damages caused, if in violation of the provisions of the Law “On the Entrepreneurs and Commercial Companies”, carries out the following transactions contrary to this Law:
- a) Returns to the partners the contributions;
 - b) Pays interests or dividends to the partners;
 - c) Distributes the company's assets;
 - ç) Allows the company to continue to do business when based on the financial status, should have been foreseen that it will not be able to pay its debts;
 - d) Grants loans.
- 19.7 Besides the claim for compensation of damages attributable personally to the administrator, the members individually or jointly, have the right to file criminal charges against the Administrator
- 19.8 The plaintiffs are entitled to pursue legal means for the full repayment of damages caused to the company, including financial compensation, if necessary.



- 19.9 Not any decision of the Assembly can forbid the lodging of a claim against the Administrator for the mistakes committed by him during his office.

Chapter IV
Financial Year – Expert

Article 20

Financial Year

- 20.1 The financial year commences on January 1st and ends on December 31st, of each calendar year. Except for the first financial year, which commences from the date of registration of the company in the National Business Center, and is closed on December 31st.

Article 21

Experts

- 21.1 The certified accountant expert is appointed by the decision of the General Assembly. The expert has the obligation to control the entire accounting documentation of the economic activity of the commercial company, the annual and the periodic control performed from him in cases when he has been appointed and has performed such duty charged by the members.
- 21.2 At the end of the control, the certified accountant expert prepares the report, in writing, for issuing the results of the annual balance sheet, as well as the report for the periodical controls, which is obliged to present and submit in time to the members for deliberation and approval based on their right to vote.

CHAPTER V

Dissolution- Restructuring of the Company

Article 22

Dissolution and Liquidation

- 22.1 The Company can be dissolved at any time, under the following circumstances:
- a) By expiry of the period for which it was established;
 - b) By decision of the General Assembly;
 - c) By opening of the bankruptcy procedures;



- ç) If it has not carried out any business activities for two years and has not notified its inactive status in accordance with paragraph 3 of Art. 43 of Law No. 9723 “On the National Business Centre”;
- d) By court decision;
- 22.2 In this case the Partners take the decision, in writing, in which foresee the method of liquidation of the company by appointing one or more liquidators, and any documents issued by the company should have the name of the liquidators and the additional nomination “Company in liquidation”.

Article 23

Restructuring the company Merger- Division

- 23.1 The company can be divided, merged based on the Decision of the General Assembly of the Partners according to the legal provisions foreseen in Part IX of the Law no. 9901, dated 14.04.2012 “On the entrepreneurs and Commercial Companies.

Article 24

Litigations


- 24.1 Any dispute arising out of or related with the implementation or interpretation of this Statute, as well as any dispute between the Company and third parties, shall be referred to the Albanian Court.

MEMBERS

OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY

“GIRASSOL ENERGIES ALBANIA”

GIRASSOL HOLDING LIMITED


15 June 2023
-AHMED ALMUBARAK-